

UDHËZUES PARANDALIMI PËR ÇËSHTJE SHËNDETI

PËRMBAJTJA

UDHËZUES PARANDALIMI PËR ÇËSHTJE SHËNDETI

PJESA I

VEPRIMET BAZË PËR PARANDALIMIN E SËMUNDJEVE

FEMRAT

ADOLESHENTËT

Vaksinimi	4
PARANDALIMI DHE REHABILITIMI NGA SUBSTANCAT: DUHANI – ALKOOLI –NARKOTIKËT	
PIRJA E DUHANIT	5
ALKOOLI	5
SUBSTANCA NARKOTIKE	5

PJESA II

VEPRIME PARANDALIMI TË SËMUNDJEVE TË RREZIKSHME PARANDALIMI I SËMUNDJEVE INFEKTIVE

1. HEPATITET	8
2. TUBERKULOZI	10
3. HIV / AIDS (SIDA)	11
4. MALARIA	12
5. VIRUSI I NILIT PERËNDIMOR	13
6. SHËNDETI SEKSUAL – MBROJTJA NGA SËMUNDJET SEKSUALISHT TË TRANSMETUESHME	15
7. SHËNDETI PSIQIK	16

PJESA III

STRUKTURA DHE ORGANIZIMI I SISTEMIT SHËNDETËSOR

1. Struktura e sistemit shëndetësor grek	19
2. Aksesit në shërbimet shëndetësore të spitaleve shtetërore	20

PJESA IV.

TË DREJTAT DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

1. Aksesit i emigrantëve të ligjshëm në shërbimet shëndetësore	24
2. Aksesit në shërbimet shëndetësore për emigrantë pa dokumentacionin e nevojshëm	28
3. Emigrantët e kthyer dhe homogjenët	29
4. Refugjatët dhe personat që kërkojnë azil	29
Entet e Mbrojtjes së të Drejtave të Emigrantëve	31

ANEKS

TELEFONA TË NEVOJSHËM DHE INFORMACIONE	33
--	----

QENDRA MJEKËSORE-SOCIALE (IAK) TË RRETHIT TË ATIKËS SPITALE TË (S.Sh.K.) SISTEMIT SHËNDETËSOR KOMBËTAR PËR PERIFERI SHËNDETËSORE

Shëndeti përcaktohet nga Organizata Ndërkombëtare e Shëndetësisë si gjendja e mirëqenies së plotë fizike, psiqike dhe sociale, dhe nuk kufizohet vetëm në mungesën e sëmundjes ose të të qenit sëmurë. (WHO, Migration and Health, 1986).

PJESA I

VEPRIMET BAZË PËR PARANDALIMIN E SËMUNDJEVE

Parandalimi përbën mënyrën më efektive të përballimit të sëmundjeve kryesore të kohës sonë. Qëllimi i parandalimit është që çfarëdolloj ndryshimi në gjendjen shëndetësore të haset në kohë dhe të përballohet në mënyrë efektive.

Parandalimi parësor ka të bëjë me mënyrën e shëndetshme të jetesës (p.sh. mënyrë e saktë e të ushqyerit, mospirje duhani, fizkulturë), ndërsa parandalimi dytësor i referohet analizave parandaluese për zbulimin e sëmundjeve, para se ato të shfaqen me simptoma klinike.

FEMRAT

Shëndeti riprodhues lidhet me jetën seksuale të kënaqshme dhe të sigurt të personit, si dhe aftësinë e riprodhimit të lirë. Shëndeti riprodhues i femrës promovohet nëpërmjet informimit dhe vizitës së rregullt mjekësore-gjinekologjike. Femrat duhet të bëjnë analizat e mëposhtme:

- Për diagnozën e hershme të kancerit të gjirit: mastografi çdo dy vjet për femrat me moshë nga 40 - 50 vjeçe dhe çdo vit për femrat me moshë > 50 vjeçe.
- Për diagnozën e hershme të kancerit të qafës së mitrës: test PAP çdo vit për të gjitha femrat seksualisht aktive.
- Vaksinë kundër Kancerit të Qafës së Mitrës për vajza dhe te reja nga 12 deri 26 vjeçe.

Femrat që kanë siguracion mund të vizitohen falas pasi të mbyllin takim në pavionet e pacientëve të jashtëm të spitaleve shtetërore dhe njësisve shëndetësore të vendit.

Gjithashtu, për femrat me siguracion janë të detyrueshme analizat e mëposhtme të kontrollit prenatal (para lindjes), me qëllim lindjen e fëmijëve të shëndetshëm:

- Analiza për konfirmimin e heterozigotëve të anemisë mesdhetare
- Elektroforeza e hemoglobinës
- Analiza e ADN-së së embrionit
- Përcaktimi i antritropave të rubeolës
- Kontroll i kariotipit të embrionit në femra mbi 35 vjeçe

Analizat kryhen falas në spitalet shtetërore dhe në Njësitë Shëndetësore të EOPYY.

Emigrantet që nuk banojnë në mënyrë të ligjshme në vend, nuk kanë të drejtën e kujdesit prenatal dhe lindjes. I vetmi përjashtim është kryerja e analizave të kontrollit prenatal ekskluzivisht për femra shtatzëna në moshë jo madhore.

ADOLESHENTËT

Adoleshenca është një stad tranzit gjatë së cilit fëmija kalon gradualisht në fazën e pjekurisë. Për arsye të ndryshme në trup dhe organizëm, adoleshentëve u rekomandohet që të kryejnë çdo vit analizat laboratorike të mëposhtme:

- Analizë të përgjithshme gjaku dhe urine, çdo vit.
- Analizë kolisteroli, në mënyrë të veçantë për adoleshentë me historik familjar sëmundjesh kardio-vaskulare.
- Matje e glicemisë esëll çdo dy vjet për adoleshentë me historik familjar diabeti të tipit II në familjarë të gradës së 1-rë dhe të 2-të.

Analizat kryhen në Pavionet e Pacientëve të Jashtëm të të gjitha spitaleve të vendit, në njësitë shëndetësore të O.K.Sh.Sh. (Organizata Kombëtare e Shërbimeve Shëndetësore) dhe në Qendrat Shëndetësore.

Vaksinimi



Vaksinat që duhen bërë nga të gjithë adoleshentët janë:

1. Seria DTP (Rekomandohet rivaksinim Td çdo dhjetëvjeçar)
2. Poliomieliti
3. Dy doza MMR
4. Seria e vaksinimeve për hepatit B
5. Vaksinim për hepatitin A
6. Vaksina e konjuguar e meningokokut të tipit C
7. Vaksina e lisë së dhenve (Varicella) në rast se nuk janë sëmurur prej saj.
8. Vaksinë kundër Kancerit të Qafës së Mitrës (për vaizat dhe të rejtat nga 12 deri 26 vjeçe)

Vaksinat kryesore mbulohen nga Arkat e Siguracioneve.

PARANDALIMI DHE REHABILITIMI NGA SUBSTANCAT: DUHANI – ALKOOLI – NARKOTIKËT

PIRJA E DUHANIT



Pirja e duhanit përbën rrezik për organizmin e njeriut. Sëmundjet që lidhen me pirjen e duhanit janë kanceri i mushkërive, sëmundjet kronike të mushkërive, osteoporoza, kanceri i gojës, i ezofagut si dhe probleme të riprodhimit dhe shtatzanisë.

Klinika të Prerjes së Duhanit funksionojnë në Spitale Shtetërore dhe Private të vendit.

Linja e Prerjes së Duhanit të Shoqatës Pneumonologjike Greke Telefon: 800 801 80 80.

ALKOOLI



Përdorimi i alkoolit shkakton vartësi fizike dhe psiqike e mund të shkaktojë akoma edhe vdekjen për arsye të shkatërrimit të mëlçisë.

SUBSTANCA NARKOTIKE



Narkotikët janë substanca kimike të cilat shkaktojnë vartësi dhe përdorimi i tyre i tepruar çon drejt vdekjes. Për çfarëdolloj vartësie duhet kërkuar në kohë ndihma e specialistëve.

Telefona të nevojshëm:



Ofrim shërbimesh të këshillimit afatgjatë të personave të cilët përballojnë probleme vartësie vetë ata ose personat e ambientit të tyre të afërm.

E Hënë – E Premte, 9 a.m. - 8 p.m.

Telefoni: **1031**

Njësia e Rehabilitimit të Narkomanëve dhe Alkoolikëve

18 e lart – Njësi rehabilitimi e Spitalit Psikiatrik të Atikës

Përballim problemesh që kanë të bëjnë me varjen nga substancat narkotike dhe alkooli.

E Hënë – E Enjte, 10 a.m.. - 8 p.m., E Premte, 10 a.m. - 4 p.m.

Telefoni: 210 - 361 7089

Njësia e Ndhmës Telefonike Urgjente «ITHAKI»

Gjithë 24orëshin. Telefoni: **1145**. Informim përsa u përket substancave narkotike, informacion për shërbimet dhe mbështetje psikologjike për përdoruesit e substancave psikotrope, si dhe mjedisit të tyre familjar/miqësor.

Telefona të mbështetjes psikologjike dhe ndihmës urgjente për adoleshentë dhe fëmijë:



«Buzëqeshja e fëmijës – To hamogelo tou paidiou» (<http://www.hamogelo.gr>)

SOS: **1056** Linjë e mbështetjes së fëmijëve

Në telefona përgjigjen psikologë fëmijësh, punonjës socialë dhe vullnetarë. Funksionon gjithë 24-orëshin.



Shoqëria e Shëndetit Psiqiko-social të Fëmijës & Adoleshentit (E.P.S.Y.P.E.) (<http://www.epsype.gr>)

SOS: 801 801 11 77 Linja e Mbështetjes së Fëmijëve & Adoleshentëve

Linja u drejtohet prindërve, fëmijëve, adoleshentëve, mësuesve, profesionistëve të shëndetit psiqik dhe në përgjithësi kujtdo personi që ka nevojë për mbështetje.

Orari i funksionimit të linjës: Çdo ditë, 9:30 a.m. deri 8:30 p.m., Të Shtunave: 9:30 a.m. deri 2:30 p.m.

PJESA II
VEPRIME PARANDALIMI TË SËMUNDJEVE
TË RREZIKSHME

PARANDALIMI I SËMUNDJEVE INFEKTIVE

Sëmundjet infektive ose ngjitëse ndodhin për shkak të depërtimit në organizëm të një agjenti patogjen që transmetohet në persona të tjerë, të cilët ose janë të sëmurë ose bëhen bartës të transmetimit të sëmundjes. Sëmundjet infektive mund të shkaktojnë epidemi në një popullsi të caktuar, ndërkohë që në mjaft raste mund të çojnë akoma edhe drejt vdekjes. Për këtë arsye është i domosdoshm parandalimi i tyre. Zbatimi i rregullave të higjienës personale dhe publike si dhe vaksinimi përbëjnë masat më efektive të parandalimit të transmetimit të sëmundjeve.

1. HEPATITET

Hepatiti është sëmundje e mëlçisë. Format më të shpeshta të hepatitit janë Hepatiti A, B ose C.

Hepatiti A është sëmundje e kurueshme e mëlçisë që shkaktohet nga virusi HAV dhe mund të zgjasë nga disa javë deri në mjaft muaj. Rreziku i infektimit vjen nga:

- ambjente të infektuar të përdorimit të përbashkët (p.sh. banja)
- ujë i infektuar, ushqime të pagatuara të cilat janë larë me ujë të infektuar
- kontakt i afërm me persona të infektuar

Hepatiti B është inflamacion i mëlçisë i cili shkaktohet nga virusi (HBV). Rreziku i infektimit vjen nga:

- kontakti seksual me persona të infektuar
- objekte të infektuara me gjak (p.sh. shiringa, brisqe, furça dhëmbësh, gjilpëra)
- kontakt me gjakun e personit të infektuar
- nënë e infektuar (tek foshnja gjatë lindjes)

Hepatiti C

Rreziku i infektimit vjen nga:

- objekte të infektuara me gjak
- kontakti seksual me persona të infektuar
- nënë e infektuar (tek foshnja gjatë lindjes)

Si mund të mësoj nëse kam hepatit?

Nevojitet kryerja e një analize laboratorike të veçantë. Kjo analizë mund të kryhet në Pavionet Hepatologjike të Pacientëve të Jashtëm në spitalet shtetërore në të gjithë vendin. Rekomandohet kryerja e analizës një herë çdo vit.

Si mund ta evitoj hepatitin?

Hepatitet A dhe B mund të evitohen nëpërmjet vaksinimit. Vaksinimi rekomandohet për fëmijët nga mosha një vjeç dhe për persona të cilët udhëtojnë në vende me përçindje të mëdha infeksioni. Vaksina për hepatitin B bëhet në tre doza dhe rekomandohet përsëritja çdo 3-5 vjet. Për kurimin e hepatitit C nuk ekziston vaksinë.

Vaksinat për hepatitin bëhen në çfarëdo spitali publik.

Gjithashtu, mund ta blini vaksinën në farmaci dhe ta bëjë farmacisti.

Veçanërisht, personat që kërkojnë azil mund të vaksinohen në Qendrat Mjekësore-Sociale (ish PIKPA).

Masa mbrojtëse kundër Hepatiteve A, B, C:

- Rregulla të rrepta të higjienës personale
- Përdorim prezervativi gjatë kontaktit seksual
- Përdorim personal i shiringave, gërshërave, brisqeve etj.
- Përdorim i veglave të sterilizuara për mirëmbajtjen e thonjve, akupunkturë, tatuazh, shpim veshësh për vathë etj.
- vaksinim (për Hepatitin A, B)

2. TUBERKULOZI

Sëmundje transmetuese që shkaktohet nga mikrobi. Prek zakonisht mushkëritë por edhe organe të tjera të trupit, si psh kockat, laringun, etj.

Cilat janë simptomat?

Simptomat e tuberkulozit përfshijnë lodhje të theksuar, humbje në peshë, temperaturë, djersitje natën, dhembje gjoksi dhe kollitje gjaku.

Si transmetohet?

Tuberkulozi transmetohet nëpërmjet kollës, të folurit të theksuar, teshtitjes dhe të qeshurit.

Si mund të mësoj nëse kam tuberkuloz?

Testi brendalëkuror mantoux është e vetmja mënyrë e diagnozës së tuberkulozit. Analiza kryhet në spitale, qendra shëndetësore, klinika të Sistemit Shëndetësor Kombëtar dhe në shërbimet higjiëno-sanitare të të gjithë vendit. Vaksina (BCG) për tuberkulozin bëhet në foshnje dhe fëmijë të vegjël në moshën 6 vjeç. Vaksina kundër tuberkulozit nuk mbron plotësisht nga sëmundja. Tuberkulozi kurohet plotësisht, por me ritme të ngadalta (më shume se 6 muaj).

Si mund të mbrojt personat rreth meje?

- Me marrje të saktë të ilaçeve
- Duke mbuluar gojën me shami gjatë kollitjes dhe teshtitjes
- Duke evituar kontaktet e ngushta me persona të tjerë, sidomos në shkolla ose ambiente pune.
- Me ajrosje të shpeshtë të ambienteve të qëndrimit

Dy me tre javë pas fillimit të terapisë, nuk e transmetoni sëmundjen. Nëse është dakord edhe mjeku juaj, atëherë mund të vazhdoni rregullisht rutinën tuaj të përditshme.

3. HIV / AIDS (SIDA)



HIV është virus që prek organizmin e njeriut. Kur dikush infektohet, mbetet përjetë bartës HIV seropozitiv dhe mund ta transmetojë sëmundjen në persona të tjerë. Personi që vuan nga SIDA ka sistem imunitar të dobësuar dhe në mjaft raste drejtohet në vdekje. Këtë moment nuk ekziston terapi për HIV.



Si transmetohet?

- Nëpërmjet kontaktit seksual (vaginal, anal, oral) pa përdorim prezervativi, me një person që është infektuar nga virusi.
- Nëpërmjet kontaktit seksual pa prezervativ me përdorues të substancave narkotike intravenoze
- Me përdorim të aqveve të pasterilizuara
- Me përdorim të përbashkët të shiringave apo aqveve për substanca narkotike intravenoze
- Nga nëna që është bartëse e virusit

Si mund të mësoj nëse jam infektuar me virusin?

Duhet kryer test diagnostik. Ky test mund të bëhet ose falas në spital publik ose me pagesë në laborator privat diagnostik-mikrobiologjik. Kryhet në mënyrë anonime dhe rezultati është konfidencial. Testi kryhet gjithashtu edhe në çfarëdo qendre kombëtare të referimit të AIDS.



Ku mund të drejtohem për informacion?

Qendra e Kontrollit & Parandalimit të Sëmundjeve (KE.EL.P.NO)

Rruga 3 Septemvriu nr. 54 & Politehniou 9, Athinë ~ Tel.: 210-52.12.000

Qendrat Kombëtare të Referimit të AIDS _Qendra Kombëtare e Referimit të Aids e Greqisë Jugore, Shkolla Kombëtare e Shëndetit Publik

Bulevardi Aleksandras 196, Athinë ~ Tel.: 210-64.47.941 **Qendra e Referimit të AIDS dhe Sëmundjeve Seksualisht të Transmetueshme të Spitalit Periferial të Rrethit të Atikës «EVANGJELISMOS»**

Rruga Ipsilantu 45-47, Athinë ~ Tel.: 210-72.00.001 **Qendra Kombëtare e referimit të Sëmundjeve Seksualisht të Transmetueshme & AIDS, Spitali I Sëmundjeve Vener. & Derm. «A. Singros»**

Rruga I. Dhragumi nr.5 Ilisia ~ Tel.: 210-72.43.579 **Organizata jo qeveritare: Qendra e Jetës**, rruga Diocharous nr. 9, Ilisia ~ Tel.: 210-72.57.617, 210-72.33.848 **ACT UP**, rruga Nikitara nr.8-10, Athinë ~ Tel.: 210-33.05.500 **Sinteza**, www.hiv.gr

4. MALARIA

Malaria është një sëmundje e transmetueshme që prek rruazat e kuqe të gjakut. Shkakton infeksion të rëndë dhe në rast se nuk përballohet me terapinë e përshtatshme, mund të çojë edhe drejt vdekjes.

Si transmetohet?

Me pickimin e mushkonjave të infektuara, me transfuzion

gjaku, transplatim organesh dhe përdorim aqesh apo shiringash të infektuara. Më rrallë transmetohet nga nëna tek embrioni.

Cilat janë simptomat?

Simptomat e malaries përfshijnë temperaturë të lartë me ethe, djersitje, dhembje koke, dhembje muskulare, marrje mendsh, diarre, të vjella, anemi, ngjyrë të verdhë të syve, të lëkurës dhe të mukozave (verdhëz).

Si mund të mësoj nëse kam malarie?

Diagnoza e malaries bëhet me analizë gjaku. Analiza mund të bëhet në spitalet shtetërore.

Si kurohet malaria?

Përballohet me trajtim farmaceutik. Terapia duhet të fillojë në kohë.

5. VIRUSI I NILIT PERËNDIMOR

Është sëmundje që transmetohet kryesisht nëpërmjet pickimit të mushkonjës së infektuar dhe më rrallë nëpërmjet transfuzioneve, transplatimeve apo nga nëna tek embrioni. Nuk transmetohet nga njeriu në njeri nëpërmjet kontaktit të zakonshëm (psh. prekje, puthje) ose kontaktit seksual apo kontakti tjetër. Personat me moshë mbi 50 vjeç gjenden në rrezik më të madh të sëmuren më rëndë nëse infektohen.

Cilat janë simptomat?

Më të shumtët e njerëzve nuk shfaqin simptoma. Simptomat e lehta përfshijnë temperaturë, lodhje, dhembje koke, dhembje muskulare, dhembje kockash dhe kyçesh, të vjella, puçrra

dhe më rrallë enjtje të gjendrave limfatike. Simptomat e rënda të sëmundjes (shfaqen në përqindje më të vogël se 1% e pacientëve) përfshijnë temperaturë të lartë, dhembje koke, mospërkulje qafe, çorientim, terror, gjendje komatoze, paralizë muskulare. Nëse nuk trajtohet në kohë, kjo sëmundje mund të çojë në encefalit, meningit, meningito-encefalit ose paralizë të lehtë. Simptomat shfaqen zakonisht 2-14 ditë pas pickimit nga insekti.

Si mund të mësoj nëse kam virusin e Nilit Perëndimor dhe si kurohet ai? Pacienti duhet të kërkojë kujdes mjekësor. Në rastet e lehta, simptomat largohen pas mjaft ditësh. Në rastet më të rënda do të jetë i nevojshëm shtrimi në spital. Nuk ekziston vaksinë kundër këtij virusi.

Masa të përgjithshme mbrojtëse nga insektet

Për mbrojtjen nga insektet mund të merren masat e mëposhtme:

- Përdorim kremërash apo sprej insekticide në lëkurën e zbuluar dhe mbi roba, sidomos nga muzgu deri në agim.
- Përdorim rrobash që mbulojnë të gjithë trupin (mëngë të gjata dhe pantallona)
- Dushe të shpeshta për largimin e djersës
- Vendosje rretash (sita) kundër mushkonjave në dritaret e shtëpisë
- Përdorim insekticidesh
- Largim i ujërave të ndenjura nga legenët, enët, vazot e luleve etj
- Përdorim ventilatori ose kondicioneri
- Përdorim llambash me ngjyrë të verdhë për ndriçimin e ambjenteve të jashtme

6. SHËNDETI SEKSUAL – MBROJTJA NGA SËMUNDJET SEKSUALISHT TË TRANSMETUESHME

Sëmundjet seksualisht të transmetueshme (SST), si psh. klamidia, sifilisi, gonorrea, blenorrea, lythat, herpesi i organeve gjenitale, transmetohen nga një person të tjetrit gjatë kontaktit seksual. Transmetohen nëpërmjet seksit vaginal, anal dhe oral.

Cilat janë simptomat?

Sëmundjet seksualisht të transmetueshme shkaktojnë shqetësime dhe dhembje në zonën e organeve gjenitale. Nëse nuk kurohen me terapinë e përshtatshme, mund të shkaktojnë sterilitet ose akoma edhe kancer.

Çfarë duhet të bëj?

Nëse mendoni se mund të jeni infektuar, vizitoni menjëherë mjekun, në mënyrë që tju rekomandojë terapinë e përshtatshme. Gjithashtu:

- Informoni partnerin tuaj seksual në mënyrë që të vizitojë mjekun
- Kufizoni numrin e partnerëve tuaj seksualë
- Mos kryeni marrëdhënie seksuale nëse partneri juaj është infektuar ose ndien shqetësime
- Pas kontaktit seksual urinoni dhe lani zonën e organeve gjenitale sa më shpejt që të jetë e mundur.

Si mund të mbrohem?



Përdorni prezervativ në çdo kontakt seksual.

Përdorimi i prezervativit ul mundësinë e transmetimit të sëmundjeve seksualisht të transmetueshme. Gjithashtu, përdorimi i tij ndalon transmetimin e sëmundjeve infektive siç është HEPATITI.



Ku mund të drejtohem për informacion?

Në pavionet e pacientëve të jashtëm të spitaleve të Sistemit Shëndetësor Kombëtar ofrohet falas ndihmë mjekësore dhe medikamente si dhe hospitalizim për të huajt që janë infektuar nga HIV si dhe sëmundje të tjera infektive.



ΥΠΟΥΡΓΕΙΟ ΥΓΕΙΑΣ & ΚΟΙΝΩΝΙΚΗΣ ΑΛΛΗΛΕΓΓΥΗΣ
ΚΕΝΤΡΟ ΕΛΕΓΧΟΥ & ΠΡΟΛΗΨΗΣ
ΝΟΣΗΜΑΤΩΝ (ΚΕ.ΕΛ.Π.ΝΟ.)

Qendra Kombëtare e Referimit të Sëmundjeve Seksualisht të Transmetueshme & AIDS, Spitali i Sëmundjeve Vener. & Derm. «A. Sin-gros», Rruga I. Dragumi nr.5 Ilisia " Tel.: 210-72.43.579 **Spitali i Sëmundjeve të Veçanta Infektive të Selanikut,** rruga Dhelfon nr.124 Tel.: 2310- 886.300 Në mjek gjinekolog ose dermatolog-venereolog.

7. SHËNDETI PSIQIK

Problemet psiqiko-sociale janë mjaft të shpeshta dhe shkaktojnë ndjenja mërzitjeje, ankthi, depresioni, lodhjeje, kapitjeje, dëshpërimi ose hiperaktiviteti, stresi ose dorëheqjeje. Simptomat e mësipërme mund të largohen me ndihmën e duhur. Shërbime psiqiko-sociale u ofrohen fëmijëve dhe të rriturve, por edhe grupeve ose familjeve, falas, pa u nevojitur siguracion dhe duke u mbrojtur konfidencialiteti i të dhënave personale. Gjithashtu, shpesh vihet në dispozicion edhe informacion në gjuhë të tjera.



Ku mund të drejtohem?

SPITALI EGINITIO – Klinika e Psikiatrisë Ndërkulturore të Universitetit të Athinës

U shërben emigrantëve me ndihmën e përkthyesve (210 7291388)

SPITALI I FËMIJËVE P.&A. QIRJAKU, Sektori i Mjekësisë Sociale

Ofron vizita pediatrike, vaksinime, evaluim zhvillimi dhe mbështetje psiqiko-sociale për të gjitha grupet shoqërore të pambrojtura. (210 7726809).

Qendra Kombëtare e Ndihmës së Shpejtë

Ofron shërbime të mbështetjes sociale (konsultative, mbështetje psikologjike, mikpritje temporare në bujtina për persona, familje ose grupe në krizë ose gjendje nevoje urgjente. (Tel.: 210 6497710).

Ente të Ofrimit të Trajtimit Shëndetësor Falas për të huajt që nuk kanë leje qëndrimi.

PRAKSIS-Poliklinika

Funksionon Poliklinikë, Farmaci dhe Shërbim Social në Athinë dhe Selanik. Ofrohet falas ndihmë mjekësore dhe mbështetje sociale për persona pa siguracion, roma (ciganë), refugjatë dhe emigrantë etj.

(Adresa: rruga Peoniu nr. 5, Platia Viktorias, Athinë " Telefona: 210 8213704, 210 8213713)

Mjekët e botës (Iatroi tou Kosmou)- Poliklinika

Funksionon Poliklinikë e Hapur në Athinë dhe Selanik. Ofrohet falas ndihmë mjekësore dhe mbështetje psiqiko-sociale për persona të varfër, pa siguracion, të pastrehë, roma (ciganë), refugjatë dhe emigrantë.

(Adresa: Mihail Vodha nr.15, Athinë " Telefona: 210 3213150, 210 8233653)

Qendra Greke e Kujdesit Shëndetësor Psikiatrik Ndërkulturor

Njësi të shëndetit psiqik që ofrojnë shërbime rehabilitimi dhe ri-integrimi dhe për grupe shoqërore të pambrojtura që jetojnë ose kërcënohen me përjashtim shoqëror. Adresa: rruga Plutarhu nr. 10, Athinë " Telefon: 210 7221707.

Qendra Ditore Babel e Organizatës Joqeveritare –Syn-eirmos:

Ofron shërbime të shëndetit psikik tek emigrantët. Adresa: rruga Mithimnis nr. 27B, Kipseli ~ Telefona: 2108616280 dhe 2108616266. Funkcionon Të Hënë – Të Premte, 09:00 - 17:00

KRYQI I KUQ I GREQISË

Organizon programe të mbështetjes psikiko-sociale dhe konsultative për emigrantët. Telefon: 210 3603449.

PJESA III

STRUKTURA DHE ORGANIZIMI I SISTEMIT SHËNDETËSOR

1. Struktura e sistemit shëndetësor grek

Ndihma shëndetësore në Greqi ofrohet nga Sistemi Shëndetësor Kombëtar (ESY). ESY i ofron mbështetje mjekësore popullatës që banon ligjërisht në vend. Shërbimet Shëndetësore Parësore (dmth shërbimet dhe vizitat që kanë të bëjnë me parandalimin dhe diagnozën) ofrohen nga klinikat bujqësore, poliklinikat bashkiake, qendrat shëndetësore periferiale, klinikat e pacientëve të jashtëm dhe Pavionet e Rasteve Urgjente (TEP) të spitaleve.

Për personat e siguruar, ofrohen shërbime të ndihmës shëndetësore nga Arkat e Siguracioneve Shoqërore, me më kryesorin Organizmin Kombëtar të Ofrimit të Shërbimeve Shëndetësore (EOPYY). Që prej vitit 2011 degët shëndetësore të arkave të siguracionit IKA-ETAM (Instituti i Sigurimeve Shoqërore), OGA (Organizmi i Sigurimeve të Bujqve), OAEE-TEVE (Organizmi i Siguracioneve të Profesionistëve të Lirë) dhe OPAD/TYDKY (Organizmi i Kujdesit Shëndetësor të të Siguruarve të Sektorit Shtetëror) përfshihen në entin unik të siguracioneve EOPYY.

Siguracioni është i detyrueshëm dhe mbulon të punësuarit grekë dhe të huaj (trogëtarë dhe profesionistë të lirë) dhe pensionistë (direkt të siguruar), si dhe anëtarët e familjeve të tyre dhe të papunët. Shërbimet shëndetësore që mbulohen nga organizmat sigurues janë:

- Kujdesi parësor mjekësor dhe dentar (parandalim dhe diagnozë e sëmundjes pa shtrim në spital, dhënie medikamentesh, transportim urgjent me ambulancë nga EKAV (Qendra Kombëtare e Ndhmës së Shpejtë), perkujdesje në shtëpi, etj.)

- Ndhimë shëndetësore spitalore
- Ndhimë shëndetësore farmaceutike
- Ndhimë shëndetësore shtesë

Në sistemin shëndetësor grek ekzistojnë edhe ente private të ofrimit të shërbimeve shëndetësore, si psh klinikat private personale, klinikat e mëdha dhe shtëpitë e lindjes (maternitetet).

2. Akses i shërbimeve shëndetësore të spitaleve shtetërore

Vizita në Klinikat e Pacientëve të Jashtëm për vizitë mjekësore parandaluese bëhet me mbyllje takimi. Vizita mjekësore në Klinikat mëngjesore të Pacientëve të Jashtëm kushton 5 euro. Monitorimi është falas vetëm për pacientët e Klinikës kundër tuberkulozit.

Procedura e vizitës

Vizita në Klinikën e Pacientëve të Jashtëm

1. Për takim të programuar në Klinikën e Pacientëve të Jashtëm të Spitalit është e domosdoshme Karta e Pacientit. Karta e Pacientit lëshohet nga Sekretaria e Klinikës së Pacientëve të Jashtëm
2. Pacienti duhet të marrë numër përparësie për tu shërbyer
3. Komunikim me Sekretarinë e Klinikës së Pacientëve të Jashtëm – Arkat dhe pagesa e koston së vizitës
4. Lëshim fature dhe pritje për tu vizituar



Procedura e shtrimit në spital (hospitalizimi)

Shtrimi i pacientëve në Spitalet e vendit kryhet sipas procedurës së mëposhtme:

- Personi që ka nevojë për ndihmë mjeksore, shkon në Pavionin e Rasteve Urgjente të spitalit që punon edhe natën
- Vizitohet falas dhe nëse rasti konsiderohet urgjent, personi i interesuar shtrohet në spital. Duhet të sjellë me vete pasaportën e tij dhe librezën e shëndetit.

Kostoja e procedurës së shtrimit në spital është rreth 15 euro, ndërkohë që çdo ditë hospitalizimi kushton mesatarisht 60 euro. Nëse pacienti ka siguracion, këto kosto mbulohen nga enti i tij i siguracioneve dhe ai vetë paguan vetëm një pjesë të koston së hospitalizimit. Nëse pacienti nuk ka siguracion dhe librezë shëndetësore, duhet të paguajë vetë të gjithë shumën.

Të gjithë personat që kanë siguracion mund të vizitojnë spitalet e mëdha që punojnë vazhdueshëm (roje nate) dhe që kanë pavion dentar.

Kujdesi bazë mjekësor dhe farmaceutik ofrohet edhe nga shërbime të tjera të sektorit publik, por edhe nga organizata jofitimprurëse.

KLINIKAT BASHKIAKE TË BASHKISË SË ATHINËS

Klinikat bashkiake të Bashkisë së Athinës ofrojnë vizita dhe shërbime shëndetësore falas, të cilat nuk kërkojnë shtrim në spital, për ata persona që kanë leje qëndrimi dhe janë banorë të rajonit Bashkiak të Athinës. Telefon: 210-5245159

Qendra e Kontrollit dhe Parandalimit të Sëmundjeve (KEEL-PNO), Zyra e popullatave të lëvizshme dhe Zyra e Mbështjtes Psoqiko-sociale

Programe të posaçme kontrolli dhe parandalimi që kanë të bëjnë me vaksinime, kontrole shëndetësore parandaluese dhe informim të emigrantëve dhe roma (ciganë). Telefon: 210 8899238, 210 8899028.

OJQ ORGANIZATA JOQEVERITARE QË OFROJNË KUJDES SHËNDETËSOR FALAS

Disa Organizata Joqeveritare u ofrojnë kujdes shëndetësor falas, analiza laboratorike, medikamente dhe udhëzime edhe të huajve që nuk disponojnë dokumenta ligjore qëndrimi (shih Pjesën II) si dhe:

Klimaka:

Shërbime mjekësore dhe psiqiko-sociale grupeve shoqërore të pambrojtura, mbështetje dhe përkujdesje. Telefon: 210-34.17.160.

Këshilli Grek për refugjatët

Disponon shërbim social, i cili ndërhyt në entet dhe shërbimet shëndetësore përta u përket çështjeve të refugjatëve dhe ofron mbështetje psiqiko-sociale. Telefon: 210-38.14.710.

Qendra Mjekësore e Rehabilitimit të Viktimave të Torturave

Ofron shërbime të rehabilitimit konsultativ, psikologjik dhe social, shoqërime dhe ndërhyrje në shërbimet shëndetësore për refugjatët-personat që kërkojnë azil, të cilët u janë nënshtruar torturave. Telefon: 210-36.46.837

Instituti Grek i Solidaritetit dhe bashkëpunimit, Qendra e integritit Socialo-ekonomik të të huajve që kërkojnë azil, në Aspropirgo të Atikës

Ofrohet strehë, ushqim, mbështetje mjekësore dhe farmaceutike, punësim krijues. Telefon: 210 7234456

Euxini Poli

Qendër Informacioni dhe mbështetjeje të grupeve shoqërisht të përjashtuara (emigrantë të kthyer, roma (ciganë), refugjatë, emigrantë etj). Ofron mbështetje psikiko-sociale dhe konsultative përsa u përket çështjeve të shëndetit, strehimit, siguracinit, mbështetjes ligjore, promovimin në punësim. Telefon: 210 2406731.

KARITAS HELLAS

Disponon Shërbim Social dhe ofron mbështetje, ushqim, ndërhyrje në shërbimet mjekësore për refugjatët, emigrantët dhe grupe të tjera shoqërore të pambrojtura (Telefon: 210 5247879).

PJESA IV. TË DREJTAT DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

1. Aksesi i emigrantëve të ligjshëm në shërbimet shëndetësore

Shtetasit e huaj që banojnë ligjërisht në vend kanë të drejta të barabarta me shtetasit grekë përsa i përket sigurimit kombëtar dhe mbrojtjes sociale (Ligji 2910/2001). Marrja e së drejtës përsa ka të bëjë me shërbimet e kujdesit shëndetësor vërtetohet nëpërmjet librezës së shëndetit nga entet/arkat e siguracioneve.



Përfitimet

Përfitimet shëndetësore mbi të cilat kanë të drejta personat e siguruar përfshijnë:

Parandalimi (Preventimi) shëndetësor

Ofrohen detyrimisht dhe pa pagesë nga i siguruari: a) Vaksinime të fëmijëve dhe të të rriturve, b) analiza të kontrollit prenatal për femrat dhe meshkujt, c) mastografi dhe test PAP për diagnozën në kohë të kancerit, d) analiza për parandalimin e sëmundjeve të zemrës dhe e) analiza për diagnozën në kohë të kancerit të zorrës së trashë dhe të kancerit të prostatit në meshkujt.

Për personat me siguracion, vaksinat që hyjnë në Programin Kombëtar të Vaksinimeve jepen nga farmacitë private pa pagesë nga ana e të siguarit. Për ata që nuk kanë siguracion, vaksina duhet blerë me shpenzimet e tyre.

Kujdesi shëndetësor i gradës së parë

Personi me siguracion i cili gëzon të drejtën e kujdesit shëndetësor, si dhe anëtarët (e siguruar) të familjes së tij, kanë të drejtën të vizitojnë:

- mjekë në klinikat e EOPYY dhe në klinikat e tyre private, kur nuk ekzistojnë njësi shëndetësore të organizuara
- mjekun familjar (aty ky ekziston ky institucion)
- mjekun bujqësor
- qendrat shëndetësore.

Gjithashtu:

- Të thërrasin në shtëpi një mjek të EOPYY nëse janë në shtrat
- Të kryejë analiza të përgjithshme apo të veçanta, ose terapi të veçanta në laboratorët e EOPYY ose në laboratorë privatë të kontraktuar, pa barrë financiare.
- Të integrohen në programe rehabilitimi në qendra të posaçme
- Të nënshtrohen fertilizimit in vitro
- Të thërrasin ndihmën e shpejtë
- Të integrohen në programin e kujdesit shëndetësor të rregullt në kushte shtëpie
- Të kërkojnë kthim të pjesshëm ose të plotë të totalit të parave që i paguan si shpërblim mjekut privat për vizitën ose ilaçet që iu dhanë.

Kujdesi spitalor

